



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 82/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.02.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “Safe” shpk, nga procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-93069-11-06-2018, me objekt: “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të depove të ujit” - Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 12 muaj”, me fond limit 5,969,212 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 18.12.2018, nga autoriteti kontraktor, Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Dibër.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “Grand Security” shpk, nga procedura e prokurimit të mësipërcituar.

Autoriteti kontraktor:

Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Dibër.
Adresa: Rruga “Ismail Feta”, lagjia “Treg”, Dibër, Peshkopi.

Ankimues:

“Safe” shpk
Adresa: Rruga “Bernard Bitola”, kulla “Hawai-Tower”, nr. 17, kati i I-rë, Tiranë.

“Grand Security” shpk
Adresa: Maqellar, Dibër.

Subjekte të Interesuara: “Eurogjici-Security” shpk
Adresa: Rruga “Adem Jashari”, Lagjia nr 8, Hyrja nr 10, Ap nr 2
Tiranë.

“Kevenjo” shpk
Adresa: Lagjia e re, Peshkopi Diber.

“Trezhnjeva” shpk
Adresa: Njësia Nr. 7, ish Fusha e Aviacionit, godina Nr. 22, Pallati
Nr. 2, Kati III, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e

prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave të operatorët ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.11.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-93069-11-06-2018, me objekt: “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të depove të ujit” - Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 12 muaj”, me fond limit 5,969,212 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 18.12.2018, nga autoriteti kontraktor, Sh.a Ujësjellës Kanalizime Dibër.

II.2. Në datën 13.12.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit sa më sipër cituar.

II.3 Në datën 18.12.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Eurogijci Security” shpk	5,831,852.90 lekë	kualifikuar
2. “Kevenjo” shpk	5,831,852.90 lekë	kualifikuar
3. “Trezhnjeva” shpk	5,831,852.90 lekë	kualifikuar
4. “Safe” shpk	5,831,852.90 lekë	skualifikuar
5. “Grand Security” shpk	5,831,852.90 lekë	skualifikuar
6. “International Security Albania” shpk	5,831,852.90 lekë	skualifikuar
7. “Nazeri 2000” shpk	5,831,852.90 lekë	skualifikuar
8. “Snajper Security” shpk	5,831,852.90 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 18.12.2018, operatori ekonomik “Safe” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimime arsyet se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se per proceduren e sipërpërmendur Operatori Ekonomik:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.
- Nuk plotëson kriteret e vecanta të përcaktuara në DT.
- Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës nuk ka gabime aritmetike.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit të publikuar në SPE, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” kreu VII, neni 66, pika 3.

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” kreu VII, neni 66, pika 4, Komisioni konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta operatorit ekonomik “SAFE” Shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme për këtë procedurë. Konkretisht:

Operatori ekonomik “SAFE” Shpk, ka paraqitur në këtë procedurë prokurimi dokumentin e leshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Diber me nr. R-30 prot., datë 30.04.2018, mbi “Vlerësim performancë të subjektit SHPSF-se “SAFE” 1.3A”. Dokument i cili është jashtë afatit kohor ligjor mbi vlefshmerinë e dokumentacionit si akt administrativ (brenda 3 muajve).

Për sa me sipër dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “SAFE” Shpk, është i paplote pasi nuk ka përmbushur Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në lidhje me kapacitetin teknik pika 2.

II.4.1. Në datën 24.12.2018, operatori ekonomik “Safe” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi, me argumentat në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

Sh.p.s.f “Safe” sh.p.k mori dijeni në faqen zyrtare të Agjencisë të Prokurimit Publik ëëë.app.gov.al me njoftimin e renditjes së operatoreve ekonomike pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik me objekt “Sherbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të depove të ujit”, e organizuar nga Autoriteti Kontraktor Sh.a Ujesjelles Kanalizime Diber zhvilluar në datë 13.12.2018. Në zbatim të nenit 63 i LPP “Te drejtat e personit të interesuar” po ju dergojme këtë ankesë duke ju sqaruar si vijon:

a.KVO-ja e ngritur nga A.K Sh.a Ujesjelles Kanalizime Diber për vlerësimin e operatoreve në këtë procedurë ka publikuar në dt 18.12.2018 në faqen qeveritare ëëë.app.gov.al renditjen si më poshtë:

Vlerësimet për tenderin “Sherbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të depove të ujit” (Faza e vlerësimit të tenderit).

1.	“Eurogjici Security” shpk	5,831,852.9 lekë	kualifikuar
----	---------------------------	------------------	-------------

2.	"Kevenjo" shpk	5,831,852.9 lekë	kualifikuar
3.	"Trezhnjeva" shpk	5,831,852.9 lekë	kualifikuar
4.	"Safe" shpk	5,831,852.9 lekë	skualifikuar
5.	"Grand Security" shpk	5,831,852.9 lekë	skualifikuar
6.	"International Security Albania" shpk	5,831,852.9 lekë	skualifikuar
7.	"Nazeri 2000" shpk	5,831,852.9 lekë	skualifikuar
8.	"Snajper Security" shpk	5,831,852.90 lekë	skualifikuar

b. KVO-ja e ngritur nga A.K Sh.a Ujesjelles Kanalizime Diber per vleresimin e operatoreve ne kete procedure ka publikuar ne dt 18.12.2018 ne faqen qeveritare ëëë.app.gov.al argument per skualifikimin e "Safe" shpk si me poshte vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se per proceduren e siperpermendur operatori ekonomik: • Nuk ploteson kerkesat e pergjithshme per kualifikim. • Nuk ploteson kriteret e vecanta te percaktuara ne DT. • Persa i perket llogaritjes se vleres se ofertes nuk ka gabime aritmetike. Komisioni i Vleresirnit te Ofertave konstaton se oferta nuk permban te gjithë dokumentacionin e kerkuar ne dokumentet e tenderit, referuar listes se kerkesave te tenderit te publikuar ne SPE, ne mbështetje te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" kreu VII, neni 66, pika 3. Ne mbështetje te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 914, date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" kreu VII, neni 66, pika 4, Komisioni konstatoi se oferta eshte paraqitur pa gabime aritmetike ne vlere. Nga shqyrtimi i kesaj oferte ne mbështetje me Nenin 53 te Ligjit 9643, date 20.11.2006, "Per Prokurimin publik" i ndryshuar si dhe dokumentave te tenderit te miratuara, u konstatua se oferta operatorit ekonomik "Safe" Shpk nuk eshte ne perputhje me kerkesat e tenderit, duke e cilesuar si oferte te pavlefshme per kete procedure. Konkretisht: Operatori ekonomik "Safe" Shpk, ka paraqitur ne kete procedure prokurimi dokumentin e leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Diber me nr. R-30 prot., date 30.04.2018, mbi "Vleresim performance te subjektit SHPSF-se Safe 1.3A". Dokument i cili eshte jashte afati kohore ligjore mbi vlefshmerine e dokumentacionit si akt administrativ (brenda 3 muajve). Per same siper dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik "Safe" Shpk, eshte i paplote pasi nuk ka permbushur Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ne lidhje me kapacitetin teknik pika 2.

Se pari ne DST-ne e kesaj procedure nga Autoriteti Kontraktor ne piken 2 te Kapacitetit teknik shtojca 8 shprehimisht kerkohej: Akti i Miratimit te Qendres se Kontrollit, miratuar nga Policia Qarkut Diber me seli ne qytetin e Peshkopise si dhe Dokumenti i performances mbi mbi menyren e ushtrimit te aktivitetit te operatorit ekonomik sipas udhezimit nr.130, date 05.03.2018 i Ministrit te Puneve te Brendshme "Per funksionimin e sherbimit privat te sigurise fizike". Per kete duhet te paraqese vertetim nga Drejtoria e Policise se Qarkut Diber ku te jepet informacion i mesiperm i kerkuar.

Se dyti ne nenin 46/1 te L.P.P percaktohet se: Operatoret ekonomike per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e

meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jo diskriminuese:

Kurse ne nenin 55/2 po te L.P.P percaktohet se: Autoriteti kontraktor vlereson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.

Se treti duke iu referuar legjislacionit te sipercituar dhe kriterit te vendosur ne DST ne te cilin ne asnje rresht nuk eshte paracaktuar nje afat kohor prej tre muajsh, argument i KVO-se per skualifikimin tone bie poshte dhe eshte i pabazuar dhe ne ligjin e prokurimit publik neni 55 pika 2 qe ju ilustruam me siper. Pra ne rastin konkret anetaret e KVO-se kane perdorur si arsye skualifikimi nje kriter qe nuk eshte perfshire ne dokumentat standare te tenderit.

Se katerti ju sqarojme se dokumenti i leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Diber me nr. R-30 prot., date 30.04.2018, mbi "Vleresim performance te subjektit SHPSF-se Safe I.3A" eshte ne perputhje si me dispozitat e Ligjit 75/2014 ashtu dhe me ato te Udhezimit nr 130 date 05.03.2018 legjislacion ky i pasqyruar dhe ne dokumentin ne fjale si dhe permbush dhe tejkalon me se miri kerkesat e vendosura nga A.K ne DST e kesaj procedure.

Ne perfundim per sa me lart kerkojme nga AK te korrigjoke shkeljen e KVO-se duke kualifikuar O.E Safe sh.p.k.

Per sa me siper dhe ne zbatim te L.P.P ju kerkojme:

- 1. Shqyrtimin dhe marrjen parasysh te ankeses tone.*
- 2. Kualifikimin e shoqerise Safe sh.p.k.*
- 3. Publikimin e klasifikimit te ri.*

II.4.2. Në datën 31.12.2018, me shkresën nr. 916 prot, operatori ekonomik "Safe" shpk, është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.4.3. Në datën 04.01.2018, pala ankimuese operatori ekonomik "Safe" shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Në datën 18.12.2018, operatori ekonomik "Grand Security" sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimime arsyet se:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se per proceduren e sipërpërmendur operatori ekonomik: • I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim. • Nuk plotëson kriteret e vecanta të përcaktuara në DT. • Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës nuk ka gabime aritmetike.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit të publikuar ne SPE, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” kreu VII, neni 66, pika 3.

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” kreu VII, neni 66, pika 4, Komisioni konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me Nenin 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta operatorit ekonomik “Grand Security” Shpk nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme per kete procedure. Konkretisht:

Operatori ekonomik “Grand Security” Shpk, ka paraqitur ne kete procedure prokurimi dokumentin e leshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Diber (ne menyre elektronike) me Nr. T00724307, date 12.12.2018, mbi “Vertetim per kontributetet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore per tatimpaguesin – E-SIG 02/a” per subjektin “Grand Security” Shpk, ku konstatohet ne kete dokument si dhe ne listpagesat shoqeruar bashkelidhur qe per muajin shtator 2017 numrin i kontributeve (punonjes te siguruar) eshte 9 (nente) si dhe per muajin dhjetor 2017 numrin i kontributeve (punonjes te siguruar) eshte 10 (dhjete). Dokument i cili nuk eshte ne perputhje dhe sipas kerkeses se AK te parashikuara ne dokumentet e tenderit ne kriteret e vecanta ne lidhje me kapacitetin teknik pika 3 ku kerkohet: 3. Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhen Shtator 2017 - Shtator 2018 per 10 punonjes per cdo muaj, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 10 punonjës të siguruar në muaj (10 punonjes sherbimi roje) si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin.

Gjithashtu konstatohet qe subjekti “Grand Security” Shpk ka paraqitur ne kete procedure prokurimi 5 (pese) certifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave, ku nderkohe ne dokumentet e tenderit te publikuara ne sistemin e prokurimit elektronik te kriteret e vecanta te kualifikimit ne lidhje me kapacitetin ligjore te operatoreve ekonomik pika 3 kerkohet: 3. Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 10 punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Diber. Per sa me siper dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “Grand Security” Shpk, eshte i paplote pasi nuk ka permbushur Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ne lidhje me kapacitetin ligjore te operatoreve ekonomik pika 3 dhe ne lidhje me kapacitetin teknik pika 3.

II.5.1. Në datën 24.12.2018, operatori ekonomik “Grand Security” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi, me argumentat në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

Nepermjet mesazhit elektronik jam njohur se me date 18.12.2018, eshte bere klasifikimi i ofertave te paraqitura ne tenderin e zhvilluar nga autoriteti kontraktor Sh.a Ujesjelles Kanalizime Diber Adresa Diber Peshkopi, Lagjja “Treg”, Rruga “Ismail Feta”, Me objekt “Sherbimi i ruajtjes dhe sigurise fizike me roje private te depove te ujit” - Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara per 12 Muaj. Nga mesazhi i ardhur kuptuam se ne kete tender kane mare pjese operatore ekonomik te poshteshenuar:

1.	“Eurogjici Security” shpk	5,831,852.9 lekë	kualifikuar
2.	“Kevenjo” shpk	5,831,852.9 lekë	kualifikuar
3.	“Trezhnjeva” shpk	5,831,852.9 lekë	kualifikuar
4.	“Safe” shpk	5,831,852.9 lekë	skualifikuar
5.	“Grand Security” shpk	5,831,852.9 lekë	skualifikuar
6.	“International Security Albania” shpk	5,831,852.9 lekë	skualifikuar
7.	“Nazeri 2000” shpk	5,831,852.9 lekë	skualifikuar
8.	“Snajper Security” shpk	5,831,852.90 lekë	skualifikuar

Nga klasifikimi i bere kuptojme se OE “Grand Security” eshte skualifikuar ne kete procedure prokurimi per aresyjet e meposhtme:

1- Operatori ekonomik “Grand Security” shpk, ka paraqitur ne kete procedure prokurimi dokumentin e leshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Diber (ne menyre elektronike) me Nr. T00724307, date 12.12.2018, mbi “Vertetim per kontributetet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore per tatimpaguesin - E-SIG 02/a” per subjektin “Grand Security” shpk, ku konstatohet ne kete dokument si dhe ne listpagesat shoqeruar bashkelidhur qe per muajin shtator 2017 numrin i kontributeve (punonjes te siguruar) eshte 9 (nente) si dhe per muajin dhjetor 2017 numrin i kontributeve (punonjes te siguruar) eshte 10 (dhjete). Dokument i cili nuk eshte ne perputhje dhe sipas kerkeses se AK te parashikuara ne dokumentet e tenderit ne kriteret e vecanta ne lidhje me kapacitetin teknik pika 3 ku kerkohet: 3.Vertetim nga Drejtoria e Tatimeve per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen Shtator 2017 - Shtator 2018 per 10 punonjes per cdo muaj, shoqeruar me listpagesat e sigurimeve shoqerore (formularet E-sig 025/a) per kete periudhe te konfirmuara nga organet tatimore.

2- Gjithashtu konstatohet qe subiekti “Grand Security” shpk ka paraqitur ne kete procedure prokurimi 5 (pese) certifikata per punonjes sherbimi ne fushen e veprimtarise se sherbimit per ruajtjen dhe sigurimin fizik te objekteve dhe pronave, ku nderkohe ne dokumentet e tenderit te

publikuara ne sistemin e prokurimit elektronik te kriteret e vecanta te kualifikimit ne lidhje me kapacitetin ligjore te operatoreve ekonomik pika 3 kerkohet: 3. Certifikata per punonjes sherbimi - ne fushen e veprimtarise se sherbimit per ruajtjen dhe sigurimin fizik te objekteve dhe pronave per te pakten 10 punonjes sherbimi te leshuara nga Drejtoria e Policise e Qarkut Diber. Per sa me siper dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Grand Security” shpk, eshte i pa plote pasi nuk ka permbushur Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ne lidhje me kapacitetin ligjore te operatoreve ekonomik pika 3 dhe ne lidhje me kapacitetin teknik pika 3.

Konstatimi I - Operatori ekonomik “Grand Security” shpk, ka paraqitur ne kete procedure prokurimi dokumentin e leshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Diber (ne menyre elektronike) me Nr. T00724307, date 12.12.2018, mbi “Vertetim per kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore per tatimpaguesin - E-SIG 02/a” per subjektin “Grand Security” shpk, ku konstatohet ne kete dokument si dhe ne listpagesat shoqeruar bashkelidhur qe per muajin shtator 2017 numrin i kontributeve (punonjes te siguruar) eshte 9 (nente) si dhe per muajin dhjetor 2017 numrin i kontributeve (punonjes te siguruar) eshte 10 (dhjete). Dokument i cili nuk eshte ne perputhje dhe sipas kerkeses se AK te parashikuara ne dokumentet e tenderit ne kriteret e vecanta ne lidhje me kapacitetin teknik pika 3 ku kerkohet: 3. “Vertetim nga Drejtoria e Tatimeve per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen Shtator 2017 - Shtator 2018 per 10 punonjes per cdo muaj, shoqeruar me liste pagesat e sigurimeve shoqerore (formularet E-sig 025/ a) per kete periudhe te konfirmuara nga organet tatimore.

Po japim shpjegimet për arsyen e skualifikimit

Konstatimi I - Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, tek kapaciteti teknik pika 3 ne DST eshte kerkuar: “3. Vertetim nga Drejtoria e Tatimeve per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen Shtator 2017 - Shtator 2018 per 10 punonjes per cdo muaj, shoqeruar me liste pagesat e sigurimeve shoqerore (formularet E-sig 025 a) per kete periudhe te konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht 10 punonjes te siguruar ne muaj (10 punonjes sherbimi roje) si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin. Per te vertetuar kete pike OE “Grand Security” ka paraqitur Vertetimin e tatimeve nr. T00724307 date 12.12.2018 ku per periudhen Shtator 2017 - Shtator 2018 ne total kam te punesuar 292 Roje objekti ku per nje muaj bie $292 / 13 \text{ muaj} = 22.46$ roje te punesuar e siguruar ne muaj. KVO gjate vleresimit te ofertave ka gabuar se pse nuk merte ne konsiderat muajt e tjere ku kishte te punesuar mbi 30 roje objekti. Autoriteti kontraktor aplikon standarde te dyfishta ne vleresimin e ofertave. I shprehur qe ne nenin 1 te ligjit te prokurimit publik, qellimi i procedurave te prokurimit publik eshte te rrishe eficencen dhe efikasitetin e perdorimit te parave publike, te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit dhe te nxise konkurrencen e te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithë operatorët ekonomike pjesemarrës ne procedura prokurimi. Ne nenin 46, pika 1 germa “b” te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Per

prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomike, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomike vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, prandaj duhet të kualifikohet OE “Grand Security” sepse është skualifikuar si pa bazuar në ligj dhe fakte. Pretendimi i ngritur nga KVO për skualifikim nuk qëndron për piken e parë.

Po japim shpjegimet për arsyen e skualifikimit

Konstatimi II - Gjithashtu konstatohet që subjekti “Grand Security” shpik ka paraqitur në këtë procedurë prokurimi 5 (pesë) certifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave, ku ndërkohë në dokumentet e tenderit të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik të kriteret e vecanta të kualifikimit në lidhje me kapacitetin ligjor të operatorëve ekonomik pika 3 kërkohej: “3. Certifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 10 punonjës shërbimi të leshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Diber. Për sa më sipër dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Grand Security” shpik, është i pa plotë pasi nuk ka përmbushur Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në lidhje me kapacitetin ligjor të operatorëve ekonomik pika 3 dhe në lidhje me kapacitetin teknik pika 3. - Tek Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomike është kërkuar: “3. Certifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 10 punonjës shërbimi të leshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Diber”. Për të vërtetuar këtë pikë OE ka paraqitur vërtetim nga PQD nr.320/2, datë 08.10.2018 Vlerësim Performancë për subjektin “Grand Security” ku ka 18 punonjës shërbimi të licensuar e të mbaruar kursin e licensimit. Ku bashkangjitur janë edhe Certifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave konkretisht 14 (katërmbëdhjetë Certifikata për punonjës shërbimi) ku i keni në sistem dhe bashkangjitur dokument). KVO gjatë shqyrtimit të ofertave nuk e ka vlerësuar mirë ofertën e dhënë nga OE sepse Certifikata për punonjës shërbimi janë futur në sistem njëherë 5 cope e pjesa tjetër prej 9 cope është futur bashkë me autorizimin për mbajtje arme në shërbim për punonjësit e shpërf-ve. Pra pretendimi i ngritur se OE ka 5 (pesë) certifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave nuk qëndron duke u bazuar në prova të pa kontestueshme sic është vërtetimi nga PQD nr. 320/2, datë 08.10.2018, Vlerësim Performancë për subjektin “Grand Security” ku ka 18 punonjës të licensuar dhe licensat e tjera që KVO nuk i ka parë. Pretendimi i ngritur nga KVO për skualifikim nuk qëndron për piken e dytë.

Duke u nisur nga me larte kerkojme: Pranimin e ankeses OE “Grand Security” duke e kualifikuar ate.

II.5.2. Në datën 31.12.2018, me shkresën nr. 918 prot, operatori ekonomik “Grand Security” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me pranimin pjesërisht të ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor konkretisht si më poshtë.

Ne ankesen tuaj drejtuar Autoritetit Kontraktor - sh.a Ujesjelles - Kanalizime Diber (ardhur ne institucionin tone me date 24.12.2018 dhe protokolluar me nr. 142 prot), per proceduren e prokurimit: “Kerkese per propozim”, me nr. REF-93069-11-06-2018, me objekt: “Sherbimi i ruajtjes dhe sigurise fizike me roje private te depove te ujit”, Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj, dy vend roje me tre turne (T1+T2+T3), me fond limit: 5,969,212 (pese milion e nenteqind e gjashtedhjetë e nente mijë e dyqind e dymbedhjetë) leke pa TVSH, burimi i financimit: Te ardhurat e institucionit, i zhvilluar me date 13.12.2018, Ora 10:00, ju sqarojme si me poshte: Autoriteti Kontraktor, sh.a Ujesjelles - Kanalizime Diber pasi u njoh me ankesen tuaj, ka vendosur pezullimin e kesaj procedure prokurimi deri ne shqyrtimin e plote te ankeses si dhe ka ngritur dhe komisionin per shqyrtimin e ankeses tuaj.

Komisioni i shqyrtimit te ankeses pasi u njoh me pretendimet e ngritura ne ankesen e operatorit ekonomik “Grand Security” shpk i cili ka marr pjese ne kete procedure prokurimi dhe eshte i skualifikuar nga ana e komisionit te vleresimit te ofertave me arsyen: Operatori ekonomik “Grand Security” shpk, ka paraqitur ne kete procedure prokurimi dokumentin e leshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Diber (ne menyre elektronike) me Nr. T00724307, date 12.12.2018, mbi “Vertetim per kontributetet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore per tatimpaguesin - E-SIG 02/a” per subjektin “Grand Security” shpk, ku konstatohet ne kete dokument si dhe ne listpagesat shoqeruar bashkelidhur qe per muajin shtator 2017 numrin i kontributeve (punonjes te siguruar) eshte 9 (nente) si dhe per muajin dhjetor 2017 numrin i kontributeve (punonjes te siguruar) eshte 10 (dhjete). Dokument i cili nuk eshte ne perputhje dhe sipas kerkeses se AK te parashikuara ne dokumentet e tenderit ne kriteret e vecanta ne lidhje me kapacitetin teknik pika 3 ku kerkohet: “3. Vertetim nga Drejtoria e Tatimeve per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen Shtator 2017 - Shtator 2018 per 10 punonjes per cdo muaj. shoqeruar me listepagesat e sigurimeve shoqerore (formularët E-sig 025/a) per kete periudhe te konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht 10 punonjes te siguruar ne muaj (10 punonjes sherbimi roje) si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin. Gjithashtu konstatohet qe subjekti “Grand Security” shpk ka paraqitur ne kete procedure prokurimi 5 (pese) certifikata per punonjes sherbimi ne fushen e veprimtarise se sherbimit per ruajtjen dhe sigurimin fizik te objekteve dhe pronave, ku nderkohe ne dokumentet e tenderit te publikuara ne sistemin e prokurimit elektronik te kriteret e vecanta te kualifikimit ne lidhje me kapacitetin ligjore te operatoreve ekonomik pika 3 kerkohet: “3. Certifikata per punonjes sherbimi ne fushen e veprimtarise se sherbimit per ruajtjen dhe sigurimin fizik te objekteve dhe

pronave per te pakten 10 punonjes sherbimi te leshuara nga Drejtoria e Policise e Qarkut Diber. Komisioni verifikoi ne sistemin elektronik dokumentet ligjore (DST-te) per kualifikimin e operatoreve ekonomik te cilet kane marr pjese ne kete procedure prokurimi te cilat na u vune ne dispozicion edhe nga njesia e prokurimit te firmosura nga ana e tyre dhe u njohem me vendimin e komisionit te vleresimit te ofertave, u be shqyrtimi i ankeses lidhur me pretendimet e ngritura duke verifikuar dokumentet ligjore te paraqitura ne sistemin e prokurimit elektronik dhe kontaktuan si me poshte:

1- Lidhur me piken e pare te pretendimit tuaj per sa i perket per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen Shtator 2017 - Shtator 2018 per 10 punonjes per cdo muaj konstatohet qe ne dokumentet e tenderit te publikuara ne sistemin e prokurimit elektronik per kualifikimin e operatoreve ekonomik pjesemarres ne kete procedure prokurimi konkretisht tek kriteret e vecanta te kualifikimit ne kapacitetin teknik pika 3 kerkohet: “3. Vertetim nga Drejtoria e Tatimeve per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen Shtator 2017 - Shtator 2018 per 10 punonjes per cdo muaj shoqeruar me listepagesat e sigurimeve shoqerore (formularet E-sig 025/a) per kete periudhe te konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht 10 punonjes te siguruar ne muaj (10 punonjes sherbimi roje) si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin. Operatori ekonomik “Grand Security” shpk ne kete procedure prokurimi ka paraqitur dokumentin e leshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Diber (ne menyre elektronike) me Nr. T00724307, date 12.12.2018, mbi “Vertetim per kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore per tatimpaguesin - E-SIG 02/a”, per subjektin “Grand Security” shpk, ku konstatohet ne kete dokument si dhe ne listepagesat shoqeruar bashkelidhur qe per muajin shtator 2017 numrin i kontributeve (punonjes te siguruar) eshte 9 (nente) si dhe per muajin dhjetor 2017 numrin i kontributeve (punonjes te siguruar) eshte 10 (dhjete). Dokument i cili nuk eshte ne perputhje dhe sipas kerkeses se AK te parashikuara ne dokumentet e tenderit ne kriteret e vecanta ne lidhje me kapacitetin teknik pika 3. Lidhur me pretendimin e OE ankimues per sa i perket pikes se me siperme per kualifikim nuk e permbush pasi nuk ka paraqitur numrin e punonjesve te siguruar per periudhen e kerkuar per cdo muaj (10 punonjes sherbimi roje si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin). Ne lidhje me kete pike sa pretendoni juve si OE i interesuar ju kishte lindur e drejta per ta kundërshtuar brenda 7 diteve nga data e publikimit te procedures se prokurimit, te drejte te cilen nuk e keni ushtruar. Pjesemarrje juaj ne kete procedure prokurimi konsiston me pranimin e kriterëve per kualifikimin e OE te publikuara ne SPE, ku rezulton qe dokumentacioni i paraqitur nuk eshte ne perputhje sipas kerkeseve te AK per kualifikimin e shoqerise tuaj ne lidhje me piken 3 te kapacitetit teknik ne kriteret e vecanta te kualifikimit.

Per sa me siper permendem, pretendimi ne lidhje me piken e pare te ankeses tuaj nuk qendron.

2- Lidhur me piken e dyte te pretendimit te ngritur ne ankesen tuaj per sa i perket qe numrit te certifikatave per punonjes sherbimi ne fushen e veprimtarise se sherbimit per ruajtjen dhe sigurimin fizik te objekteve dhe pronave. Komisioni i shqyrtimit te ankeses pasi verifikoi

dokumentacionin e paraqitur nga subjekti juaj ne lidhje me kete pike rezulton qe numri i certifikata per punonjes sherbimi qe keni paraqitur eshte i plote dhe sipas kerkesave te AK te percaktuara ne DST.

Per sa me siper permendem, pretendimi ne lidhje me piken e dyte te ankeses tuaj qendron.

Bazuar dhe ne ligjin nr. 9643, date 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik” (i ndryshuar) neni 46, pika 1, Autoriteti Kontraktor Sh.A Ujesjelles-Kanalizime Diber (komisioni i shqyrtimit te ankeses) vendosi pranimin pjeserisht te ankeses tuaj si me poshte:

- Mospranimin e pretendimeve ne lidhje me piken e pare te ankeses tuaj persa i perket numrit te punonjesve (sherbimi roje) te siguruar per cdo muaj.
- Pranimin e pretendimeve ne lidhje me piken e dyte te ankeses tuaj persa i perket numrit te certifikatave per punonjes sherbimi.

Persa me siper, mbeshtetur ne ligjin nr. 9643, date 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik” (i ndryshuar) neni 46, pika 1 dhe argumenteve te mesiperme, operatori juaj ekonomik mbetet i skualifikuar nga kjo procedure prokurimi pasi nuk permbushni kerkesat te percaktuara ne DST ne kriteret e vecanta te kualifikimit ne lidhje me kapacitetin teknik pika 3.

II.5.3. Në datën 07.01.2018, pala ankimuese operatori ekonomik “Grand Security” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me argumentat në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

Me kete tekste te ankeses i jemi drejtuar Ak sh.a Ujesjelles Kanalizime Diber Adresa Diber Peshkopi, Lagjja “Treg”, Rruga “Ismail Feta”, per kete procedure te prokurimit per te bere anullimin e vendimit te KVO per skualifikimin te operatorit ekonomik “Grand Sesurity” si te pa bazuar ne ligj dhe ne prova, per proceduren e lart permendur objekti i kontrates / marreveshjes kuader: “Sherbimi i ruajtjes dhe sigurise fizike me roje private te depove te ujit” - Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara per 12 Muaj por ne shkresen nr. 918 prot date 31.12.2018. Ardhur ne ambjentet e firmes me date 03.01.2019 lenda Kthim pergjigje Drejtuar “Grand Security” Adresa Maqellare Diber thekson. Komisioni i shqyrtimit te ankesave pasi verifikoj dokumentacionin e paraqitur nga subjekti Konkludoi.

I- Lidhur me piken e pare te pretendimit persa i perket per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen Shtator 2017 - Shtator 2018 per dhjete punonjes per cdo muaj rezulton qe dokumentacioni i paraqitur nga subjekti nuk eshte ne perputhje sipas kerkesave te AK per kualifikimin e shoqerise tuaj ne lidhje me piken 3 te kapacitetit teknik ne kriteret e vecanta te kualifikimit. Persa me siper permendem pretendimi ne lidhje me kete pike te ankeses nuk qendron.

2- Lidhur me piken e dyte te pretendimit te ngritur ne ankeses tuaj per sa i perket nr. te certifikateve per punonjes sherbimi ne fushen e veprimtarise se sherbimit per ruajtjen dhe sigurimin fizik te objekteve dhe pronave KSHA pasi verifikoj dokumentacionin e paraqitur nga subjekti juaj ne lidhje me kete pike rezulton qe numri i certifikatave per punonjes sherbimi qe keni paraqitur eshte i plote dhe sipas kerkesave te AK te percaktuara ne DST. Persa me siper permendem pretendimi ne lidhje me kete pike te ankeses qendron.

Nuk jemi dakort me pergjigjen e dhene nga KSHA per piken e pare per nr. e punonjesve te siguruar. Duke u nisur nga shpjegimet e bera KSHA nga dy pikat e skualifikimit ka pranuar vetem nje e duke e lene oferten e paraqitur nga OE te skualifikuar. Po japim shpjegimet tone per piken e pare te pa pranuar nga KSHA.

Po japim shpjegim per piken e I, tek kapaciteti teknik pika 3 ne DST eshte kerkuar: “3. Vertetim nga Drejtoria e Tatimeve per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen Shtator 2017 - Shtator 2018 per 10 punonjes per cdo muaj, shoqeruar me liste pagesat e sigurimeve shoqerore (formularet E-sig 025/a) per kete periudhe te konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht 10 punonjes te siguruar ne muaj (10 punonjes sherbimi roje) si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin”. Per te vertetuar kete pike OE “Grand Security” ka paraqitur Vertetimin e tatimeve nr. T00724307, date 12.12.2018 ku per periudhen Shtator 2017 - Shtator 2018 ne total kam te punesuar 292 roje objekti ku per nje muaj bie $292 / 13 \text{ muaj} = 22.46$ roje te punesuar e siguruar ne muaj. KVO gjate vleresimit te ofertave ka gabuar se pse nuk merte ne konsiderat muajt e tjere ku kishte te punesuar mbi 30 roje objekti. Autoriteti kontraktor aplikon standarde te dyfishta ne vleresimin e ofertave. I shprehur qe ne nenin 1 te ligjit te prokurimit publik, qellimi i procedurave te prokurimit publik eshte te rrishe eficencen dhe efikasitetin e perdorimit te parave publike, te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit dhe te nxise konkurrencen e te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithë operatorët ekonomike pjesemarrës ne procedura prokurimi. Kam shume te drejte kur them se Autoriteti kontraktor aplikon standarde te dyfishta ne vleresimin e ofertave. AK bashke me njesine e prokurimit kane shkelur ligjin PP qe ne pregatitjet e dst ku APP me date 22.02.2018 ka nxjere SET MODEL (Ky eshte nje set model i DST per te orientuar autoritetet kontraktore, pasi ne varesi te kushteve dhe specifikave te objektit qe ata prokurojne mund te vendosin kriteret e tjera te posacme per kualifikim). Ku per piken 3 Vertetim nga Drejtoria e Tatimeve per numrin e punonjesve te siguruar per tre muajt e fundit (), shoqeruar me listepagesat e sigurimeve shoqerore (formularet E-sig 025/a) per kete periudhe te konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht punonjes te siguruar ne muaj, punonjes sherbimi roje si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin. Pamvaresisht se ne cfare momenti jeni ne tani. Pra duke u nisur nga pretendimet e ngritura gjate shpjegimit arrijme ne konkluzionin se shpsf “Grand Security” i ka te gjithë kapacitetin e nevojshme per te kryer kete sherbim.

Pretendimi i OE per piken e pare qendron.

KSHA si ne piken e dyte qe e pranoj ankesen tone edhe per piken e pare duhet ta kishte pranuar ankesen si te bazuar ne fakte qe jane shume kokforte e te ligjshme. Nuk jemi dakort me pergjigjen e dhene nga KSHA e per kete do ti drejtohem KPP si organi me i larte ne fushen e Prokurimeve Publike duke kerkuar qe te kualifikohet OE "Grand Security". Nisur nga pretendimet e ngritura nga ana jonë tregon se arsyet e skualifikimit të OE "Grand Security", nuk qendrojnë, dhe mbi këtë bazë kërkojmë që të kualifikohet.

II.6. Me shkresën me nr. 36 prot, datë 18.01.2019, protokolluar me tonën me nr. 16/2 prot, datë 22.01.2019, me objekt "Informacion", është depozituar pranë Komisionit Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues "Safe" shpk dhe "Grand Security" shpk.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Safe" shpk, mbi kundërshtimin e vendimit të KVO-së, në lidhje me skualifikimin e tij me arsyen se: [...] *Operatori ekonomik "Safe" shpk, ka paraqitur në këtë procedurë prokurimi dokumentin e lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër me nr. R-30 prot., datë 30.04.2018, mbi "Vlerësim performance të subjektit SHPSF-së "Safe" 1.3 A". Dokument i cili është jashtë afate kohore ligjore mbi vlefshmërinë e dokumentacionit si akt administrativ (brënda 3 muajve). Për sa më sipër dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik "Safe" shpk, është i paplotë pasi nuk ka përmbushur Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në lidhje me kapacitetin teknik pika 2.. [...]"*, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në Shtojcën 8/2 "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit" pika 2.3.2 "Kapaciteti teknik" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteret si më poshtë:

"2. Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Qarkut Dibër me seli në qytetin e Peshkopisë si dhe Dokumenti i Performacës mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik sipas udhëzimit nr. 130, datë 05.03.2018 i Ministrit të Punëve të Brëndshme "Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike"

Për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Dibër ku të jepet informacion i mësipërm i kërkuar”.

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Safe” shpk, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Akt Miratimi për Qendrën e Kontrollit të SHPSF nr. 339/1 protokolli datë 25.10.2018 lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër me anë të së cilës vërtetohet se: Subjekti “Safe” me Nr. NIPT: K41424040P. Adresa e Qendrës së Kontrollit, Lagjia “Treg”, Peshkopi. “Në zbatim të nenit 22 të ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” dhe Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr.130 datë 05.03.2018 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” dhe Vendimit nr. 11-2/2 datë 08.10.2018 të Komisionit të DVP Dibër. Qendra e Kontrollit të Subjektit “SHPSF “Safe” nënkategoria I.3.A, gjendet e përshtatshme për të kryer detyrën e drejtimit, mbikëqyrjes dhe menaxhimit të veprimtarisë së sigurisë fizike”.

- Vlerësim Performance të Subjektit SHPSF-së “Safe”, 1.3 A me nr. R-30 protokolli datë 30.04.2018 lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër, ku ndër të tjera konstatohet se Ka të miratuar Qendër Monitorimi dhe Kontrolli, me adresë lagjia “Treg” Peshkopi, me nr 325, datë 30.09.2015, bashkangjitur dhe lista e punonjësve të subjekti SHPSF-së “Safe”.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

III.1.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 5, parashikohet si më poshtë: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale”, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në

dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

III.1.5. Referuar sa më sipër KPP konstaton se në kriterin e kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomik duhet të paraqesin **vertetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Diber** ku të jepet informacion mbi Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Qarkut Diber me seli në qytetin e Peshkopisë si dhe Dokumenti i Performacës mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik sipas udhëzimit nr. 130, datë 05.03.2018 i Ministrisë të Punëve të Brendshme “*Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike*”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Safe” shpk, KPP vëren se është paraqitur vërtetimi i performancës nga DVP-Diber në përputhje me kërkesat e kriterit ku është përcaktuar qartë paraqitja e vërtetimit të performancës i cili të përmbajë informacion mbi qendrën e kontrollit dhe mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik “Safe” shpk. Në këtë kuptim KPP gjykon se operatori ekonomik “Safe” shpk e plotëson kriterin e kualifikimit pasi provon se ka depozituar dokumentacionin e kërkuar në lidhje me vërtetimin e performancës nga DVP-Diber sipas formatit të parashikuar në udhëzimin nr 130, datë 05.03.2018 “*Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike*”. Lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktor se *Dokumenti i lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Diber me nr. R-30 prot., datë 30.04.2018, mbi “Vlerësim performance të subjektit SHPSF-së “Safe” 1.3 A, është jashtë afate kohore ligjore mbi vlefshmërinë e dokumentacionit si akt administrativ (brënda 3 muajve)*”, KPP e gjen të pabazuar pasi ky pretendim tejkalon kërkesat e kriterit i cili në asnjë rast nuk është parashikuar që vërtetimi i performancës i lëshuar nga DVP-Diber duhet të jetë brënda 3 muajve. KPP sqaron se në kriterin e vecantë të kualifikimit autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar që vërtetimi i performancës i lëshuar nga DVP-Diber të jetë brënda tre muajve, e rrjedhimisht operatori ekonomik nuk ka pasur detyrim të paraqesë vërtetimin e performancës brënda tre muajve.

Kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës dhe rrjedhimisht ky i fundit do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se Autoriteti kontraktor në vlerësimin e ofertave nuk mund të përdorë asnjë kriter apo specifikim tjetër i cili nuk është i përfshirë në dokumentat e tenderit kjo në kuptim të nenit 55 “*Kriteret e Përcaktimit të Ofertës Fituese*” pika 2 e LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Safe” shpk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Grand Security” shpk, mbi kundërshtimin e vendimit të KVO-së, në lidhje me skualifikimin e tij me arsyen se: [...]Operatori ekonomik “Grand Security” Shpk, ka paraqitur në këtë procedurë prokurimi dokumentin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër (në mënyrë elektronike) me Nr. T00724307, datë 12.12.2018, mbi “Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për tatimpaguesin – E-SIG 02/a” për subjektin “Grand Security” Shpk, ku konstatohet në këtë dokument si dhe në listpagesat shoqëruar bashkëlidhur që për muajin shtator 2017 numrin i kontributeve (punonjës të siguruar) është 9 (nëntë) si dhe për muajin dhjetor 2017 numrin i kontributeve (punonjës të siguruar) është 10 (dhjetë). Dokument i cili nuk është në përputhje dhe sipas kërkesës së AK të parashikuara në dokumentet e tenderit në kriteret e vecanta në lidhje me kapacitetin teknik pika 3 ku kërkohet: “3. Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Shtator 2017 - Shtator 2018 për 10 punonjës për cdo muaj, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 10 punonjës të siguruar në muaj (10 punonjës shërbimi roje) si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin.. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në Shtojcën 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteret si më poshtë:

“3. Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Shtator 2017 - Shtator 2018 për 10 punonjës për cdo muaj, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 10 punonjës të siguruar në muaj (10 punonjës shërbimi roje) si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin”.

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) operatori ekonomik “Grand Security” shpk, në përmbushje të kriterit të mësipër të vendosur nga autoriteti kontraktor ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Listëpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimimi për periudhën Shtator 2017 – Shtator 2018.
- Vërtetim Nr. T00724307, datë 12.12.2018 “Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin – E-Sig 02/a), lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën

dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”. Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.*

III.1.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 5, parashikohet si më poshtë: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale”, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

III.1.5. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret e kualifikimit i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe të kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë paisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si edhe personelin e nevojshëm, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit, për të krijuar bindjen se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara në dokumentat e tenderit si edhe për të krijuar një panoramë të qartë mbi stafin, marrëdhëniet e punës dhe vijueshmërinë e tyre. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e

autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.6. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik “Grand Security” sh.p.k nuk plotësohet kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin e *minimalisht 10 punonjësve shërbimi të siguruar në muaj, si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin për periudhën Shtator 2017 – Shtator 2018*. Ankimuesi në parashtrimet e tij në ankesë pranon faktin e mosplotësimit të numrit të punonjësve për çdo muaj sipas kriterit për kualifikim të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit ku thotë se [...] KVO gjatë vlerësimit ka gabuar se pse nuk merr në konsolidatë muajt e tjerë ku kishte të punësuar mbi 30 roje [...]. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka parashikuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të vërtetojnë se për periudhën *Shtator 2017 – Shtator 2018 disponojnë minimalisht 10 punonjës shërbimi të siguruar në muaj, si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin, dokumentuar kjo me vërtetimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore lëshuar nga Administrata Tatimore dhe listpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punesimi*. Sa më sipër, KPP nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Grand Security” sh.p.k., konstaton se ky i fundit në përmbushje të kërkesës së vendosur nga autoriteti kontraktor për të paktën 10 punonjës shërbimi të siguruar në muaj, si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin, ka dorëzuar vërtetimin për kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër dhe listpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punesimi, me anë të të cilave nuk vërtetohet se operatori ekonomik “Grand Security” sh.p.k. disponon një numër prej 10 punonjësish shërbimi si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin çdo muaj për periudhën *Shtator 2017 – Shtator 2018* të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit.

Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në

fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me lex specialis. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Grand Security” sh.p.k në këtë procedurë prokurimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

III.1.7. Gjithashtu, KPP gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor ose kriteret e tjera të kualifikimit për të cilat ka ngritur pretendime, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Grand Security” shpk nuk qëndron

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Safe” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-93069-11-06-2018, me objekt: “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të depove të ujit” - Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 12 muaj”, me fond limit 5,969,212 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 18.12.2018, nga autoriteti kontraktor, Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Dibër.
 2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Grand Security” shpk për procedurën e prokurimit të mësipërcituar.
 3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Safe” sh.p.k dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë ofertues.
 4. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Safe” sh.p.k
 6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 16 Protokoli; Datë 04.01.2019

Nr. 24 Protokoli; Datë 07.01.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha